



## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 616-23-5466-2-2-1/C1272

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe  
**AMC Marketing SH.P.K.**, Agim Ramadani nr 35, Prishtine, 811927352, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:  
**Fushate e Vetedijesimit per qenet endacak me numër identifikues: 616-23-5466-2-2-1**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

**Fushate e Vetedijesimit per qenet endacak**

|     |  |
|-----|--|
| No. | Grupi 616-23-5466-2-2-1                          |
| I   | <b>Fushate e Vetedijesimit per qenet endacak</b> |

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 13,520.00 €; [trembedhjete mije, e pesëqind e rijeze] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëfqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëfqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>2</sup> në tri originale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një originale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Ofruesin e Shërbimeve

|              |                               |              |               |
|--------------|-------------------------------|--------------|---------------|
| Emri:        | VISAR SHEHU                   | Emri:        | LABINOT GASHI |
| Pozita:      | Xydar përgjegjes i prokurimit | Pozita:      | DIREKTOR      |
| Nënshtkrimi: |                               | Nënshtkrimi: |               |
| Data:        | 14.08.2023                    | Data:        | 14.08.2023    |
| Vula:        |                               | Vula:        |               |



amc.  
marketing  
SH.P.K. PRISHTINË

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderoruesit në këtë tender.

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 616-23-5466-2-1/C1272

## Neni 1 Përkuftimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshtatshme të ofruesit.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Cmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjese e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkuption të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkuption autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkuption Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përshtatshme apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
  - a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
  - b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhëni finansiarë.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate

implementimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund te siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjeter të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

#### Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njostimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë *madhore*" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemite, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vërtëtima, vërshtimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës *madhore* do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmblidhet detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofroesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi përfundues i dëshmit të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës *madhore*. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes përfundues i pagesat e vonuara, përmosrealizim ose përfundësime nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloji tjetër i dështimit përfundues i kryer obligimet e tij është rezultat i forcës *madhore*.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës *madhore* ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofroesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorësia është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative përfundues i plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës *madhore* të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofroesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetet e tillë alternative përvëç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofroesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofroesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhëne nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim përfundues i dëshmit të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofroesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofroesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofroesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykata, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronë procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofroesi i Shërbimeve është dënuar përfundues i një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofroesi i Shërbimeve është shpallur fajtor përfundues i një shkelje që ka të bëjë me një profesion të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofroesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* përfundues i një korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofroesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin e kontratës;
- (j) Ofroesi i Shërbimeve nuk arrin t'i japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofroesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofroesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhezojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëshëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbim eve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informata e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të janë bashkërisht dhe vazhdimesh të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitet janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jetë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasoje e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënës në pjesën IV të kontratës.

## Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuar nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

16.2 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### Neni 18 Korrigimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defekti të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19 Konsekuenca e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjike për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 21                    Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**Neni 22                    Dëmshpërbëlimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbëlej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-23-5466-2-2-1/C1272

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenit përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës                     |           | Amendamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK  |
|---|-----------|--|
| Pershkrimi i nenit                                      | Nr. Nenit |  |
| Ligji i zbatueshëm<br>dhe gjuha                         | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.  |
|   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.  |
| Fillimi dhe<br>Përfundimi i<br>shërbimeve               | 6.1       | Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <b>2 dite pas nënshkrimit</b>  |
|   | 6.4       | Dhe perfundon me 14.01.2024  |
|   | 6.5       | Vendi i kryerjes së shërbimeve është <b>Komuna e Prishtinës</b>  |
| Obligimet e<br>Autoritetit<br>Kontraktues               | 12.3      | Menaxheri i Projektit është <b>zyrtari i cili caktohet me vendim te ZKA-se</b>   |
| Obligimet   |           | Operatori Ekonomik obligohet që ti ruaj te dhënat personale sipas ligjit te përmbrojtjen e te dhënavë personale<br><b>LIGJI NR. 06/I.-082</b>  |
| Sigurimi  | 10.1      | 1000 per periudhën 90 dite   |
| Siguria e ekzekutimit                                   | 14.1      | Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: <b>1352 EUR. Per periudhen 7 Muaj</b>   |
| Parimet e<br>përgjithshme të<br>pagesës                 | 16.1      | Orari i pagesës do të jetë: Pas kryerjes se punëve me konstatim nga ana e menaxherit te kontratës i cili caktohet me vendim te ZKA-se  |
| Kontrolli i kualitetit                                  | 17.1      | Sherbimet duhet te jene ne përputhje me specifikimin teknik  |
| Zgjidhja miqësore e<br>mosmarrëveshjes                  | 20.2      | KOMISIONI PER NDERMJETSIM PRANE MINISTRIS SE DREJTESIS   |
| Zgjidhja e<br>mosmarrëveshjes me<br>procedure gjyqësore | 21.1      | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>[Gjykata Komerciale] në pajtim me ligjin në Kosovë (oseb)</b> kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</b> në pajtim me <b>[specifika rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtise Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të rjojhura]</b> |

|  |  |                     |
|--|--|---------------------|
|  |  | ndärkombetarishet). |
|--|--|---------------------|

| Specifikat përfushaten vëtëdijësuse për qentë endacak |   |        |       |               |             |
|---|---|--------|-------|---------------|-------------|
| Nr.   | Përshkrimi  | Njësia | Sasia | Çmimi me TVSH | Totali      |
| 1   | Bërtjen e tri (3) videove vëtëdijësuese (40-60 sekonda)<br>Krijimin e një uebfaqe dhe postimin e materialeve vizuale<br>dhe informatave relevante përfushatën | Copë   | 3 €   | 3,200 €       | 9600        |
| 2   |   | Copë   | 1     | 2000          | 2000        |
| 3   | Realizimin e foto sesioneve në menyre të vazhdueshme  | Orë    | 24    | 80            | 1920        |
|   |   |        |       |               | € 13,520.00 |